



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:209661
Datë: 15.01.2024
Numri i dokumentit: 05188502

C-IV - 23 – 0399

Paditës: A Sh nga fshati S e U, Komuna Prizren , i përfaqësuar nga avokati B I nga Prishtina.

Kundër

Të paditurës : Ndërmarrja Shoqërore NIN „ Ramiz Sadiku ” në likuidim të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në Prishtinë, rr. ”Agim Ramadani”, nr. 23.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, në rivendosje, me dt. 15 janar 2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa e paditësit, ndryshohet **Vendimi i Autoritetit Likuidues PRZ 017 – 0004/0017**, më dt. **10. 03. 2014** ashtu që, obligohet e paditura **NSH NIN „ Ramiz Sadiku ”** që paditësit, t’ia paguaj pagat e pa paguara për periudhën **01.07.1999** deri më dt. **19.12.2005**, në shumën bruto **2,000.00€**, kamatën në lartësi **10 %** , të shumës themelore, ashtu që në pagën bruto është përfshirë kontributi në pension që paguhet në Trust dhe tatimi në burim, që paguhet në Administratë Tatimore, dhe për shpenzime të procedurës shumën **312.00 €**, sipas nenin **40.1.7** të Ligjit nr. **04/L-034** .

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me **18. 04. 2014**, pranë DHPGJS është parashtruar ankesa nga paditësi , kundër të paditurit në lidhje me Vendimet e Autoritetit Likuidues (AL) për **NSH NIN „ Ramiz Sadiku ” PRZ 017 – 0004/0017**, më dt. **10. 03. 2014** , me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave për periudhën **01.07.1999** deri më dt. **19.12.2005**, në shumën bruto **2,000.00€**, si e pa vlefshme .

Paditësi, ankesës ja ka bashkangjitur si provë :

- Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, PRZ 017 – 0004/0017, më dt. 10. 03. 2014.

Më dt. 31.07.2014, paditësi ka dorëzuar kërkesën për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore .

Më dt. 30.09.2015, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtrësën e plotësimit të ankesës me të cilën është deklaruar, se paditësi ishte në marrëdhënie pune te i padituri deri në procedurën e likuidimit të NSH –së dhe ishte në listën e pagave dhe sipas kësaj liste e paditura ishte e obliguar të paguaj pagat e pa paguara. Gjithashtu është deklaruar se marrëdhënia e punës, paditësit ju është ndërprerë për shkak të privatizimit .

Kërkesa e paditësit është refuzuar për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, pasi është konstatuar se kërkesa është parashkruar për pagat e pa paguara edhe pse në njoftim të AKM-së, atij i janë pohuar borxhet. Me këtë parashtrësë është deklaruar se përveç kërkesës për paga bruto kërkon edhe kamatën ligjore sipas dispozitave të LMD_së së vjetër dhe të ri, ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës për hartimin e ankesës në shumën 104€.

Më dt. 22.06.2021, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C-IV-14- 1760, për paditësin me të cilin ka urdhëruar plotësimin e ankesës, me prova dhe dëshmi.

Më dt. 25.08.2021 i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtrësën me të cilën ka bashkangjitur provat si vijon :

- Njoftimin e AKM_së , dt. 21.02.2006, për përfundimin e marrëdhënies së punës,
- Kopjen e Librezës së punës ,
- Listën e pagave për punëtorët e NSH –së dhe
- Vendimin e Autoriteti e Likuidimit.

Më dt. 27.08.2021 AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën në mbrojtje ndaj ankesës kundër Vendimit të AL PRZ 017- 0004/ 0017, me propozim që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi .

AKP-ja në parashtrësë është deklaruar se NSH NIN „Ramiz Sadiku ” është në procedurë të likuidimit nga data 15.05.2006, ndërsa më dt. 01.08.2006 paditësi ka ushtruar kërkesë kreditore për kompensimin e pagave të pa paguara bruto, në shumën 2,000.00€ .

Autoriteti i Likuidimit mori Vendimin PRZ 017-004/0017, me të cilin ka refuzuar kërkesën dhe vendimi mbështetet në faktet dhe bazat ligjore :

- Neni 36.2 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, parashikon „, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzimin e kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitalit apo interesit të pronësisë ...kërkesa ose pretendimi është i pasafatshme nga kufizimet kohore ”.
- Neni 608 i Ligjit për punën e bashkuar parashikon „, pagesa e shumës së pagës apo rrogës , ose ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet ”.

AKP-ja pretendon se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht .

AKP-ja pretendon se objekt i kësaj procedure është ligjshmëria e vendimit të AL . Në këtë kontekst , neni 74.2 i Ligjit or/L-086, parashikon se ankesa e dorëzuar kundër Vendimit të AL

duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhej me ligjin 04/L-034.

Prandaj në pajtim me këtë qëndrim Vendimi nuk është në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore të ligjit 04/L-034 dhe nuk ka bazë për anulimin e Vendimit.

Parashtresës, ja ka bashkangjitur Vendimin e AL PRN 017- 0004/0017 .

Më dt. 05.1.2021 Gjykata ka lëshuar Urdhër për të paditurin për tu përgjigjur në parashtresë të paditësit dt. 01.09.2021 dhe provave të dorëzuara me parashtresë .

Më dt. 18.11.2021, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar në parashtresë të paditësit dt. 01.09.2021, provave të cilat i ka dorëzuar paditësi .

Në parashtresë është deklaruar se kërkesa është refuzuar në bazën e parashkrimit të kërkesës , AL nuk lëshohet fare në shqyrtimin e çështjes për të vlerësuar meritat e kërkesës apo bazueshmërin e saj.

Rrjedhimisht kërkesat për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën 01.07.1999 deri 19.05.2005, që janë dorëzuar pas datës 01.07.2002 janë parashkruar sipas ligjit, pa ofruar asnjë të dhënë në lidhje me shumën që pretendon se është parashkruar dhe shumën që pretendon që nuk është parashkruar

Në lidhje me provat nuk është deklaruar fare.

DHPGJS më dt. 26 nëntor 2021, kishte marrë Aktgjykim C-IV- 14- 1760, me të cilën kishte aprovuar kërkesën e paditësit .

Më dt. 28.09.2023, Kolegji i Apelit me Aktvendim AC -I- 21- 0824- A 0001, e kishte kthyer çështjen në rivendosje .

Më dt. 19.10 2023, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C- IV- 23- 0399, dhe palëve ju është kërkuar të deklarohen në lidhje me pretendimeve e tyre .

Më dt. 01.11.2023 i autorizuari i paditësit me parashtresë është deklaruar : se me prova është vërtetuar fakti se paditësi ishte punëtor i të paditurës NSH, dhe ky faktë është vërtetuar me prova, lista e pagave në të cilën përfshin detyrimin e pa përmbushur, është miratuar në dhjetor të vitit 2005, ndërsa kërkesa është ushtruar më dt. 01.08.2006, gjë që nuk mund të bisedohet për kurrfarë parashkrimi. NSH e ka pranuar borxhin dhe se AL me vendimin e saj nuk mund ta mohoj detyrimin që e ka pranuar nga vet e paditura. Më tej ka shtuar se Letër pezullimi dhe lista përmbledhëse e pagave 1999- 2005, janë prova të mjaftueshme për tu miratuar kërkesa e paditësit . I autorizuari i paditësit në parashtresë është thirr edhe në praktikën e rasteve të njëjta për paga të pa paguara për periudhën 01.07.1999 deri më dt. 19.12.2005, ndaj NSH NIM ,, Ramiz Sadiku ” si S S , Aktgjykimi AC – I- 21- 0577etj.

Ka kërkuar shpenzimet e procedurës edhe për përgjigjeje në ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë në shumën 208 .00€.

Më dt. 03.11.2023, AKP-ja ka dorëzuar parashtrësën me të cilën është deklaruar se është rregull bazik që pala kërkuese ka detyrimin e barrës së provës. AK pretendon se ka bërë vlerësimin e saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar drejte .

Me parashtrësë ka bashkangjitur provat të cilat i ka dorëzuar në gjykimin e parë.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa e paditësit, është e bazuar .

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 398 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i ka ofruar paditësi, dhe pretendimet në kërkesë si dhe pretendimet e të paditurës në parashtrësë të mbrojtjes, sikundër edhe ato në rivendosje ka konstatuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi ishte punëtorë i të paditurës, deri në ditën kur të njëjtit ju është dorëzuar njoftimi për përfundimin e marrëdhënies së punës, më dt. 21.02.2006, për shkak të shitjes së aseteve të NSH –së, më dt. 21.02.2006, sikundër nuk ishte si kontestuese as lartësia e kërkesës. Por si kontestuese është çështja e parashkrimit të kërkesës për pagesën e pagave për periudhën e kërkuar .

Me njoftimin, dt. 21.02.2006, të lëshuar nga AKM-ja , paditësi është informuar në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës, ndërsa sipas njoftimit „Shuma – Pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me Punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e Punëdhënësit . Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura ”.

Me dokumentin e Librezës së punës, për paditësin vërtetohet fakti se paditësi ishte i punësuar në NSH nga dt. 18.12.1986 dhe të njëjtit ju është mbyllur librezja e punës, më dt. 21.02.2006.

Me listën e pagave të punëtorëve të NSH-së, në të cilën janë 258 punëtor, paditësi është i renditur me numrin 17 dhe sipas të njëjtës listë paga bruto është në shumën 2,000.00€, kontributi në pension i punëdhënësit është në shumën 56.00€, kontributi i punëmarrësit është në shumën 56.00€ dhe tatimi në burim 87.00€, ose shuma e pagës neto 1,857.00€.

Këtë listë e ka dhe AKP-ja , por si në Vendonim të AL ashtu edhe në parashtrësë, për këtë provë fare nuk është deklaruar, vetëm se është thirr në parashkrim të kërkesës, edhe pse ajo me njoftim e ka pranuar borxhin.

Me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ 017- 0004/0017, dt. 10.03.2014, kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 01.07.1999 deri më 19.12.2005 në shumën bruto 2,000.00€. është refuzuar si e pavlefshme duke u mbështetur në dispozitën e nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 dhe në dispozitën e nenit 608 të Ligjit për punën e bashkuar i RSFJ i vitit 1976 .

Gjykata vlerëson se dokumenti i njoftimit i dt. 21.02.2006, i lëshuar nga AKM –ja me të cilin paditësit i ka përfunduar punësimi si pasojë e shitjes së aseteve të NSH , ka prodhuar efekt juridike si për paditësin ashtu edhe për NSH NIN „ Ramiz Sadiku ”, sa i përket pushimit të marrëdhënies së punës .

Po ashtu e paditura – përfaqësuesi ligjor AKP, me të njëjtin dokument e ka pranuar faktin se shumata- pagat , të cilat nuk ju janë paguar punëmarrësit mbesin si përgjegjësi e punëdhënësit, dhe kërkesa e tillë do të shqyrtohet në procedurën e likuidimit, duke marruar për obligim që paditësi të kontaktohet kur të fillon kjo procedurë . Me këtë dokument i padituri nuk është thirr në parashkrim fare sikundër nuk e ka udhëzuar paditësin si punëtor që për kërkesën e tij mund ti drejtohet gjykatës, por kjo kërkesë sipas njoftimit ka mbetur të vendoset në procedurë të likuidimit .

Gjykata vlerëson se në kohën kur paditësit i ka pushuar marrëdhëniet e punës dt. 07.02.2006, si Ligji i punës në fuqi, ka qenë Rregullorja nr. 2001/27, për Ligjin Themelore Të Punës në Kosovë, si dhe Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD i RSFJ i vitit 1978), që ka rregulla të përgjithshme në lidhje me parashkrimin e kërkesave .

Me dispozitën e nenit 40 paragrafi 1. pika 1.7 e Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, rregullon ,, kërkesat e pasiguruara , përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritetet më të larta ”.

Me dispozitën e nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 , rregullohet çështja e kamatës e cila është e kufizuar deri në 10 % të shumës themelore.

Gjykata vlerëson se nisur nga fakti se kërkesa kreditore është ushtruar më dt. 01.08.2006, para Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, ndërsa njoftimi është lëshuar nga AKM , dt. 21.02.2006, me të cilin ka pohuar pagat e mbetura borxh, ky njoftim ka efektin juridikë të ndërprerjes së parashkrimit sipas dispozitës së nenit 387 të LMD-së (RSFJ) . Në rastin konkret pas ndërprerjes së parashkrimit, parashkrimi fillon të rrjedh përsëri nga fillimi, kurse koha e kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim, krejt kjo sipas dispozitës së nenit 392 , paragrafi 1, të LMD –së .

Mirëpo nisur nga fakti se AKM-ja ka marr për obligim ta njoftoi paditësin kur të fillojnë procedurat e likuidimit, ndërsa fillimi i procedurës së likuidimit është varur nga veprimi i AKP-së (si shkak i pezullimit) , kjo situatë juridike ka ndikuar që rrjedhja e parashkrimit të pezullohet, pra fare të mos filloi të rrjedh parashkrimi, dhe një qëndrim i tillë mbështetet në analogji të dispozitës së nenit 384, paragrafi 1 i Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve i RSFJ . Në rastin konkret për shkak të pezullimit të rrjedhjes së parashkrimit parashkrimi fare nuk ka rrjedh deri në ditën kur paditësi është njoftuar për fillimin e procedurës së likuidimit nga AKP-ja , sipas vendimit të Bordit të AKP-së.

Gjykata vlerëson prapë sikur në gjykimin e parë, se pas konstatimit të kësaj gjendje faktike, e cila ndryshon nga konstatimi i gjendjes faktike nga Autoriteti i Likuidimit, Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar në mënyrë të gabuar faktin se është parashkruar kërkesa dhe si rrjedhojë e kësaj ka zbatuar në mënyrë të gabuar edhe dispozitën e nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 .

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësit nuk është ju parashkruar kërkesa e tij kreditore dhe se të njëjtit, ju njihet e drejta për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën, prej dt. 01.07.1999 deri më dt. 19.12.2005, në shumën bruto 2,000.00€, si dhe kamata në lartësi 10%, të shumës themelore, në të cilën janë të përfshira kontributi pensional që paguhet, në Trust dhe tatimin në burim që paguhet, në Administratë Tatimore .

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se derisa AKP-ja, në njoftimin e dt. 21.02.2006, fare nuk është thirr në parashkrim, dhe në rastin konkret ajo kishte marrë për obligim ta njoftoi paditësin

për procedurën e likuidimit, ajo në Vendimin e saj refuzues nuk ka mundur të thirret në parashkrim të kërkesës, pasi e ka pohuar borxhin. Në rastin konkret kur pohohet borxhi, kjo nënkupton se është pohuar borxhi edhe për periudhën e parashkrimit të kërkesës sipas ligjit për kërkesat më të vjetra se tri vite, që dallon nga situata, kur ushtrohet padia me kërkesë të pagave, ndërsa i padituri në përgjigje në padi thirret në parashkrim.

Meqenëse Gjykata, ka vërtetuar një gjendje e njëjtë faktike si në gjykimin e parë, në bazë të provave të dorëzuara nga palët ndërgjyqës dhe pretendimeve të tyre në lidhje me parashkrimin nga ajo gjendje faktike që është vërtetuar nga Autoriteti i Likuidimit me Vendimit të ankimuar, Gjykata vendosi që Vendimi PRZ 017 -0004/0017, të ndryshohet dhe ta pranoi ankesën, duke vendosur si në dispozitiv.

Gjykata vlerëson se edhe për AKP-në- AL vlen parimi i barrës së provës, pasi ajo i ka të gjitha provat pasi është administratore e NSH –së, dhe se ajo nuk mund të kërkojë provat te punëtori, kur ajo provat i ka, ndërsa me asnjë provë të vetme nuk e ka vërtetuar dhe argumentuar pretendimin e saj për parashkrim.

Gjykata me rastin e pranimit të kërkesës së paditësit për e pa paguara, ka zbatuar dispozitën e nenit 40 paragrafi 1, pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, nr. 04/L-034.

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 63 të Ligjit për Dhomën e Posaçme paditësit ja njohu shpenzimet e procedurës në shumën 312.00€ dhe at: për ankesë 104.00€, taks gjyqësore 20 €, dhe për hartimin e ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 208.00€.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva
Gjyqtar